

## KIT – Mjeti për vetëvlerësim të njohurisë gjuhësore të finlandishtes

### Çka është KIT?

KIT është mjet pune, me të cilin mund të vlerësoh njohurinë tënde të gjuhës finlandeze. Vlerëso vet se sa mirë:

- Kupton finlandishten e folur
- Kupton finlandishten e shkruar
- Di të flasësh finlandisht
- Di të shkruash finlandisht

**KIT nuk është test zyrtar.** Rezultati **nuk mund të përdoret** për aplikimin për studime ose për aplikimin për shtetesi.

### Me rëndësi

- **Bë vlerësimin vet. Nëse dikush tjetër përgjigjet për ty, rezultati nuk është i vërtetë.**
- Në vlerësim mos shkruaj emrin ose të dhëna tjera personale.
- Shërbimet e punësimit nuk ia dërgojnë askujt rezultatin tënd.
- Rezultatin e ruajmë 3 vite.

### Pse ia vlenë të bëhet vlerësimi?

- E kupton cili është niveli i njohurisë tënde gjuhësore.
- Njohuria jote gjuhësore ndihmon Shërbimet e punësimit për të drejtuar ty në shërbime dhe shkollimet e përshtatshme..
- E kupton se cilat shkathtësi duhet të ushtrosh më shumë.

### Çka të nevojitet për të bërë vlerësimin?

- Telefon i mençur, tablet ose kompjuter
- Kufjet
- Mikrofoni
- Një dhomë e qetë (për shembull mund të përdorësh bibliotekën)

Vlerësimi zgjatë **20–60** minuuta.

### Çka ndodhë pas vlerësimit?

Përfiton një **vlerësim të përgjithshëm të njohurive tua të gjuhës finlandeze në nivelet A1–B2:** filllet, mjaftueshëm, mirë ose shkëlqyeshëm. Gjithashtu përfiton **rezultatin e katër fushave:** të folurit, kuptimi i të dëgjuarit, shkrimi dhe kuptimi i të lexuarit.

Eksperti i shërbimeve të punësimit regjistron rezultatin në të dhënat tua të punëkërkimit në Työmarkkinatori. **Rezultati përdoret kur të drejtojnë për ndonjë punë ose shërbim, që mbështesin punësimin tënd.**


# KIT- mjet për vetëvlerësim të njohurisë gjuhësore të finlandishtes

## Udhëzim përdorimi –Autori i vlerësimit


### A) Fillimi i vlerësimit



- Hap vegzën e vlerësimit, të cilën ta ka dërguar eksperti I shërbimeve të punësimit <https://tinyurl.com/Espoo-KIT>
- **VËNI RE!** Që të mund të bësh vlerësimin, ti duhet të lexosh dhe të aprovosh mbrojtjen e të dhënave dhe udhëzimet e përdorimit





- Fut (shkruaj) **PIN-kodin** që ta kanë dërguar




## B) Bërja e vlerësimit


- Vlerësimi mund të fillojë pasi të kesh verifikuar që mikrofoni punon. Jep lejen për përdorimin e mikrofonit. Pastaj fillo incizimin.



- Shtyp ikonën **mikrofoni** dhe fol në mikrofon.



- Dëgjo incizimin. Nëse kualiteti i zërit është i mire, konfirmo dëgjimin dhe shtyp butonin "Valmis aloittamaan".




## Vlerësimi fillon me detyra të lehta fillestare


- Vlerësimi fillon me detyra të lehta dhe bëhet më i vështirë sipas përgjigjeve tua. Secila fushë e aftësisë (dëgjimi, të folurit, leximi, të shkruarit) vlerësohet ndaras.
- Mos u ngut gjatë përgjigjeve sepse detyrat vijnë duke u vështirësuar përgjatë testit.
- Kur jepet detyra **për të folur, atëherë fol së paku për 30 sekonda**
  - ▶ Sa më shumë të flasësh, aq më mire sistemi identifikon përgjigjen.

## Paraqitja e pengesave / lajmërimi i tyre:

- Nëse ke probleme teknike ose nuk mund të avancosh më tutje, shtyp butonin **"Ilmoita"**. Zgjedh, çfarë problemi ke, shkruaj një përshkrim të shkurtër dhe në fund shtyp butonin **"Lähetä ilmoitus"**.





- Kur të kesh dërguar lajmërimin për problem teknik, sistemi të jep menjëherë një detyrë të re. Atëherë mund të vazhdash vlerësimin.
- **Butoni "OHJE" – udhëzimet e detyrës:** Secila detyrë ka udhëzimet e vetat. Mund të shikosh udhëzimin kur të shtypësh butonin e kaltër **"Ohje"**, që gjendet lart majtas.




## C) Rezultatet dhe kthimi I vlerësimit

- Kur të mbarojë vlerësimi, ty të hapet **faqja e rezultatit**. Në faqen e rezultatit shih **përmbledhjen e vlerësimit** si dhe **rezultatit në fusha të ndryshme të aftësisë gjuhësore**.



### Ribërja e vlerësimit

- Nëse dëshiron ta bësh vlerësimin përsëri, shtyp butonin **“Tee uudelleen”**. Mund ta bësh vlerësimin përsëri **vetëm një herë** para se ta dërgosh rezultatit.



- VËNI RE!** Mos shtyp butonin **“Lähetä tulokset”** para se të jesh i/e sigurt që dëshiron të deponosh rezultatit. Vlerësimi nuk mund të bëhet sërish pas dërgimit të rezultatit.

### Deponimi / Dërgimi i rezultatit të vlerësimit

- Shtyp butonin **“Lähetä tulokset”**.
- Rezultati I vlerësimit deponohet në sistem dhe shkon te eksperti I shërbimeve të punësimit.
- Në dritaren që hapet në ekran, shih **vegzhën e faqes së rezultateve**.
- Mund të dërgosh rezultatit në e-mailin tend, pasi të kesh shkruar adresën elektronike në fushën e postës elektronike dhe shtyp butonin **“Lähetä sähköposti”**.

